



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 dhjetor 2011
Nr. ref.: RK 167/11

AKTVENDIM PËR PAPANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 34/11

Parashtrues

Sami Bunjaku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kolegjit Gjyqësor të Dhomës së
Posaçme të Gjykatës Supreme SCC 10-0079, të 21 janarit 2011,
dhe**

**i kushtetutshmërisë së Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6,
për ndryshimin dhe zëvendësimin e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut
Nr. 2006/17, për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13, për
themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet
që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Sami Bunjaku nga Gjakova, i përfaqësuar nga z. Avdi Rizvanolli, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Trupit Gjykes të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme) SCC 10-0079, të 21 janarit 2011, i cili parashtruesit i është dorëzuar më 28 janar 2011.
3. Përveç kësaj, parashtruesi e konteston kushtetutshmërinë e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6 për ndryshimin dhe zëvendësimin e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2006/17, për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13 për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: UA UNMIK Nr. 2008/6).

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) i kushtetutshmërisë së Vendimit të Trupit Gjykes të Dhomës së Posaçme SCC 10-0079, dhe i kushtetutshmërisë së UA të UNMIK-ut Nr. 2008/6, përmes të cilave i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 5 [Gjuhët], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] në lidhje me nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 1 shkurt 2011.
7. Më 18 prill 2011, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 34/11, e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 34/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Kadri Kryeziu.
8. Më 6 maj 2011, Gjykata kërkoi dokumente shtesë nga parashtruesi për të dëshmuar nëse ai kishte ushtruar ankesë kundër Vendimit të Dhomës së Posaçme SCC 10-0079, të 21 janarit 2011, pranë Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme.
9. Më 16 maj 2011, parashtruesi i dorëzoi Gjykatës informatën shtesë të kërkuar me të cilën dëshmoi se kishte ushtruar ankesë kundër Vendimit të Dhomës së Posaçme SCC 10-0079, të 21 janarit 2011, pranë Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme.
10. Më 15 qershor 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.
11. Më 3 tetor 2011, Gjykata kërkoi nga Dhoma e Posaçme t'i paraqiste komentet e veta lidhur me ankesën e parashtruesit. Dhoma e Posaçme u përgjigj më 12 tetor 2011 duke thënë se:

“...
“

Sipas nenit 25.7 të UA të UNMIK-ut 2008/6, parashtruesat dhe dokumentet përcjellëse duhet t'i paraqiten DHPGJS në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Por, nëse paraqiten në gjuhën shqipe ose serbe, duhet të sigurohet edhe përkthimi i të gjitha parashtrësive dhe dokumenteve përcjellëse edhe në gjuhën angleze. Nëse pala (personi fizik) nuk është në gjendje, për shkak të gjendjes së tij/saj financiare, të sigurojë përkthimin e dokumenteve me shpenzimet e tija, sipas kërkesës, gjykata mund t'i ofrojë palës përjashtim nga tarifat e gjykatës dhe ndihmë me përkthimet.

Trupi Gjyqësor i DHPGJS, me vendimin e vet të 21 janarit 2011, hodhi poshtë kërkesën e Sami Bunjakut dhe të tjerëve si të papranueshme sepse parashtruesi i kërkesës i dorëzoi të përkthyerat në anglisht vetëm kërkesën dhe historinë e parcelave përkatëse kadastrale por jo edhe dokumentet e tjera. Parashtruesi i kërkesës u ankua tek Kolegji i Ankesave i DHPGJS kundër vendimit të Trupit Gjyqësor. Kjo ankesë është ende në pritje në Kolegjin e Ankesave. Prandaj, është e pamundur që DHPGJS të marrë ndonjë qëndrim lidhur me ankesën e Sami Bunjakut në rastin i cili është ende në pritje në Gjykatë.

“...
”

12. Më 24 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

13. Më 19 prill 2010, parashtruesi inicioi procedurë pranë Trupit Gjyqësor të Dhomës së Posaçme për ta verifikuar të drejtën e tij pronësore të supozuar.
14. Më 22 nëntor 2010, Trupi Gjyqësor i Dhomës së Posaçme lëshoi një urdhër për parashtruesin, në përputhje me nenin 28.4 të UA të UNMIK-ut Nr. 2008/6, përmes të cilit kërkohej që parashtruesi t'i përkthente brenda dy javëve ankesën dhe dokumentet në gjuhën angleze.
15. Më 8 dhjetor 2010, parashtruesi e përmbushi urdhrin pjesërisht.
16. Më 21 janar 2011, Trupi Gjyqësor i Dhomës së Posaçme vendosi ta refuzonte ankesën e parashtruesit, pasi ai nuk e përmbushi Urdhrin e Trupit Gjyqësor (SCC-10-079), të 22 nëntorit 2010.
17. Më 31 janar 2011, parashtruesi ushtroi ankesë kundër Vendimit të Trupit Gjyqësor të Dhomës së Posaçme SCC 10-0079, të 21 janarit 2011, pranë Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme, duke u ankuar që sipas të nenit 5 të Kushtetutës, gjuhë zyrtare në Kosovë janë gjuha shqipe dhe serbe dhe se nuk është i obliguar t'i përkthejë dokumentet në gjuhën angleze.

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi pretendon që UA e UNMIK-ut Nr. 2008/6 është në kundërshtim me nenet 5 [Gjuhët], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për gjykim të drejtë] në lidhje me nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] të KEDNJ-së.
19. Për më tepër, parashtruesi pretendon se askund në botë palët nuk janë të obliguara të komunikojnë me gjykatë në një gjuhë që nuk është gjuhë zyrtare sipas Kushtetutës. Në

këtë drejtim, parashtruesi shtron pyetjen nëse gjykata është në shërbim të vetvetes apo të qytetarëve.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Parashtruesi pretendon se i është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenet 5 [Gjuhët], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] në lidhje me nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] të KEDNJ-së. Gjkata vëren se për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, ajo së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
21. Në këtë drejtim, Gjkata thekson se mund të vendosë vetëm për pranueshmërinë e kërkesës nëse parashtruesi tregon që ai/ajo i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion sipas ligjit në fuqi në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit, që përcaktojnë:

“Neni 113.7 i Kushtetutës: Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

“47.2 i Ligjit: Individë mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”
22. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih, Aktvendim për Papranueshmëri: Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI-41/09, i 21 janarit 2010, dhe shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).
23. Në këtë rast, Gjkata vëren që parashtruesi ka ushtruar ankesë kundër Vendimit të Dhomës së Posaçme SCC 10-0079, të 21 janarit 2011, pranë Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme për t'u ankuar se sipas nenit 5 të Kushtetutës, gjuhë zyrtare në Kosovë janë gjuha shqipe dhe serbe dhe që nuk është i obliguar t'i përkthejë dokumentet në gjuhën angleze. Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme ende nuk ka marrë vendim lidhur me këtë çështje. Nëse ankesa e tij nuk është e suksesshme pranë Kolegjit të Ankesave, atëherë parashtruesi mund ta iniciojë kërkesën në këtë Gjykatë.
24. Prandaj, rezulton që parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutë dhe nenin 47 (2) të Ligjit.
25. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për shqyrtim të kushtetutshmërisë së UA të UNMIK-ut Nr. 2008/6, Gjkata vëren që vetëm palët e autorizuara sipas nenit 113.2 të Kushtetutës kanë të drejtë ta ngrenë çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Prandaj, parashtruesi nuk është palë e autorizuar sipas nenit 113.2 të Kushtetutës.
26. Për këto arsye, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 dhe 113.2 të Kushtetutës, nenit 47 (2) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese më 24 nëntor 2011, njëzëri

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani